

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"KAP" Shpk

Sot, në Tiranë, me datë 16.04.2012 (dymijë e dymbëdhjetë), në orën 10⁰⁰, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë KAP Shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin nr. 6987 datë 27/09/1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbajtëse e NUIS - J62903833Q.

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë në përputhje me parashikimet e Ligjit 9901/2008;
2. Të ndryshme.

Janë të pranishëm në mbledhje:

- Ortaku Albano Aliko, mbajtes i leternjoftimit me numer 024529047, zotërues i 82.5% të kapitalit themeltar të shoqërisë,
- Ortaku Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, zotëruese e 17.5% të kapitalit themeltar të shoqërisë, përfaqësuar me autorizim nga Stepan Ferrollari

Z. Albano Aliko, në cilësinë e Kryetarit të Asamblesë verifikon njoftimet dhe konstaton se janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët te cilet zotërojnë 100% të kapitalit themeltar dhe deklaroi Asamblenë të thirrur rregullisht dhe vendimet që do të merren prej saj mbi çështjet e rendit të ditës do të jenë të vlefshme.

Pas diskutimesh në lidhje me rendin e ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me unanimitet:

VENDOSI:

1. Miratimin e Statutit të ri të Shoqërisë në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" sipas tekstit bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Ngarkohet Z. Endi Kokoli mbajtes i leternjoftimit me numer 025466756, për regjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Pasi nuk kishte më çështje për tu diskutuar, Kryetari deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të mbyllur në orën 13⁰⁰.

ORTAKËT

Albano Aliko

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
përfaqësuar me autorizim nga:



STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KAP" SHPK

STATUTI I KAP SHPK

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KAP" SHPK

KREU I
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "KAP" Shpk, me emërtimin tregtar KAP (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Kavajë, në adresën: Lagjia Nr. 3, Kavajë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të transferojë selinë e Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimit, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore prej 99 vjet, duke filluar nga data kur është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 3.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zgjatjen e kohëzgjatjes së Shoqërisë përtej afatit të parashikuar nga N. 3.1 më sipër.

NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë në veçanti:
- Rritjen e peshkut dhe konservimin i tij, industrializimin dhe tregtimin brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë. Aktivitetin e importimit dhe eksportimit në përgjithësi dhe në veçanti të prodhimeve që kanë të bëjnë me rritjen, industrializimin dhe bërjen të tregueshëm të peshkut.
 - Shoqëria mund të zhvillojë direkt ose indirekt të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, të pasurive të tundshme dhe të patundshme të nevojshme për

STATUTI I KAP SHPK

arritjen e qëllimit të shoqërisë përgjithësisht të parashikuara në statut me qëllim realizimin e planeve ekonomike dhe financiare për realizimin e fitimit që do të ndahet ndërmjet ortakëve.

- Veprimtari ekonomike në fushën e hoteleri – turizmit, investim, ndërtim, administrim dhe shitje të ndërtesave, banesave dhe komplekseve turistike, sportive, industriale, etj si dhe shitblerje të pasurive të paluajtshme në përgjithësi;
- Investim e ndërtim i objekteve civile, turistike, ekonomike, veshje fasadash, projektimi dhe ndërtim i veprave të zakonshme prej murature tulle, guri, druri, betoni, betonarmeje, metalike;
- Kryerje transporti që konsiderohet i nevojshëm për përmbushjen e aktivitetit të shoqërisë, të japë e të marrë përsipër sipërmarrje për realizim objektsh turistike, hoteleri; administrim për llogari të vet ose të të tretëve të ndërtesave dhe/ose komplekseve turistike, hoteleve, sportive, industriale, të ndërtuara këto nga vetë shoqëria ose nga shoqëri të thera në kapitalin e të cilave ajo merr pjesë, etj.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë në fitime në ndërmarrje të tjera ose në shoqëri me anë të blerjes së aksioneve ose kuotave.
- Përveç aktiviteteve të sipërcituara, shoqëria mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër industrial, tregtar, financiar, të patundshëm, ku përfshihet dhe marrja e zonave për ndërtime dhe bërjen të tregtueshme të ndërtesave civile dhe industriale të konsideruara të nevojshme ose të përshtatshme për qëllimin shoqëror nga ana e Asamblesë së Përgjithshme.

KREU II

KAPITALI, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 3.777.511,50 Lekë (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë presje pesëdhjetë), i ndarë në 2 (dy) kuota. Kuotat e kapitalit janë kontribute në para si dhe në natyrë sipas Kontratës për Krijimin e Shoqërisë dhe rritjeve të mëpasshme të kapitalit të shoqërisë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet tërësisht si më poshtë:
- **Albano Aliko**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 02.06.1969, mbajtës i kartës së identitetit nr. 024529047, zotërues i 1 (një) kuotë të Shoqërisë, e cila përfaqëson 82,50% të kapitalit të saj, me vlerë 3.116.446,99 Lekë;
 - **Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, zotëruese e 1 (një) kuotë të Shoqërisë, e cila përfaqëson 17,50% të kapitalit të saj, me vlerë 661.064,51 Lekë;
- 5.2 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme nëpërmjet shitjes, dhurimit, ose në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji tek Ortakët ose tek personat e tretë, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë



STATUTI I KAP SHPK

Tregtare. Gjithashtu, Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale.

- 5.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

**NENI 6
ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, nëpërmjet një vendimi të cilësuar të marrë me kuorumin e përcaktuar në nenin 8.12 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 6.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 6.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

**NENI 7
ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me vendim të cilësuar të miratuar me kuorumin e përcaktuar në nenin 8.12 të këtij Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 7.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**KREU III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**NENI 8
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve



STATUTI I KAP SHPK

- në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas Statuti dhe/ose çdo Marrëveshje Ortakësh të veçantë.
- 8.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
 - 8.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
 - 8.4 Ortakët nuk mund të delegojnë të drejtat e votës për pjesë të kuotës, nëse votojnë personalisht për pjesën e mbetur të kuotës.
 - 8.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali në librin përkatës.
 - 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën në të cilën do të mbledhet Asambleja e Përgjithshme.
 - 8.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
 - 8.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
 - 8.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
 - 8.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.



STATUTI I KAP SHPK

- 8.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 8.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 8.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, reorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 9
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 9.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratorët mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i Shoqërisë emërohet:
- **Z. Albano Aliko** shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 02.06.1969, mbajtës i kartës së identitetit nr. 024529047, banues në adresën: Rruga "Dëshmoret e 4 Shkurtit", Kulla Sky Tower, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.
- 9.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji dhe ky Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 9.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori përfaqëson Shoqërinë para palëve të treta.
- 9.4 Në zbatim të këtij neni, Administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore.
- 9.5 Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



STATUTI I KAP SHPK

- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 9.6 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 10

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e N. 97 të Ligjit 9901 datë 14,04,2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU V

KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 11

KONTROLI FINANCIAR

- 11.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislationit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Eksperte Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.



**NENI 12
VITI FINANCIAR**

- 12.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 13
BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 14
DIVIDENDI**

- 14.1 Pas plotësimit të parashikimeve të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 14.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje dhe në përpjesëtim të drejtë me shumat e shlyera të kuotave për të cilat paguhet dividendi. Megjithatë, në rast se një kuotë emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit duke filluar nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 14.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të jetë interes-bartëse ndaj Shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM
ZGJIDHJA E MOSMARREVEHJEVE**

**NENI 15
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 15.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 16



LIGJI I ZBATUESHËM

- 16.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Kontratën për Krijimin e Shoqërisë, këtë Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 17

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.


NENI 18

GJUHA

- 18.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga Ortakët më datë __.04.2012.

ORTAKËT

Albano Aliko



Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
përfaqësuar me autorizim nga:

